



REPUBLIKA E KOSOVES-VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. 5	Nr. Prot. 1450
Org. Jedinica	Broj Prot.
Org. Unit	Prot. No.
Nr. i faqeve 2	Data: 21.07.2022
Stranica	Datum
No. pages	
Prishtine / e	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 21.07.2022
Nr. 5-1450

Komisioni për licencimin e BPrAL/ kolegjeve private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 3671 të datës 23.06.2022 të parashtruar nga BPrAL-kolegji “Akademia Evolucion” dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji “Akademia Evolucion”, me seli në Prishtinë në nivel institucional dhe të programeve.
2. Kohëzgjatja e licencës është tri vite (1 tetor 2022 – 30 shtator 2025) në nivel institucional sipas vendimit ref. 652/ 22 i datës 16.05.2022 i lëshuar nga Agjencioni Kosovar i Akreditimi si dhe Vendimit ref. 952/22 të datës 18.07.2022 për programet e akredituara.
3. BPrAL- kolegji “Akademia Evolucion” obligohet që çdo vit ti dëshmojë komisionit për licencim në MASHTI, se ka aplikuar në komunën përkatëse lidhur me përfitimin e lejes së ndërtimit dhe legalizimit.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim të BPrAL/ në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 3671 të datës 23.06.2022 të parashtruar nga kolegji “Akademia Evolucion”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim. Ky institucion obligohet që çdo vit të sjellë dëshminë tek komisioni për licencim se ka aplikuar me kërkesë drejtuar Drejtorisë së urbanizmit përkatëse për përfitimin e lejes së ndërtimit dhe legalizimit.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat tri vite akademike (1 tetor 2022 – 30 shtator 2025) sipas vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim të cekur ne këtë vendim.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi tek Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

